



Planuar / Dorëzuar Prilbjen/Pridato Received/Delivery	17.05.22	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHUK	2882/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.334/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.334/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike-administrative "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 16.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.334/2022 të datës 06.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes postës me datë 04.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 11899/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Gjakovës me rastin e ristrukturimit të nëpunësve të Gjendjes Civile dhe Sektorit për Inspektime ka bërë shkelje të ligjit material dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me rastin e transferimit të ankuesit nga pozita "Kurir" në pozitën "Zyrtar për Telefoni në sektorin për Siguri dhe Emergjencë" Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Gjakovë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 15.04.2022 ka bërë gujar kërkesën për përgjigje

në ankesë në Komunën e Gjakovës, ndërsa kjo e fundit me datë 28.04.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2473/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.protokolli 1899/2022 të datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me Nr.01-112/02-8061 i datës 31.03.2022; Akt Emërim i N.Sh. me Nr.01-112-143/41 i datës 12.03.2012; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 15.04.2022; Përgjigje në ankesë i datës 28.04.2022; Vendim me Nr.01-112/02-6281 i datës 15.03.2022; E-mail nga T.K. për A.Gj. i datës 15.03.2022; E-mail nga T.K. për N.SH. i datës 15.03.2022; Flete dorëzimi me Nr.01-112/02-6281; Vendim me Nr.01-112/02-6886 i datës 21.03.2022; E-mail nga J.H. për T.K. i datës 21.03.2022; E-mail nga T.K. për T.V. i datës 23.03.2022; Propozim me Nr. 01-112/02-7590 i datës 28.03.2022; E-mail nga T.K. për N.SH. i datës 31.03.2022; Flete dorëzimi me Nr. 01-112/02-8061; Pliko me nr. R2077726 i datës 26.04.2022; E-mail nga I.Ll. për I.M.SH. i datës 12.05.2022; E-mail nga I.M.SH. për I.Ll i datës 11.05.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi .

sepse:

Ankuesi, i punësuar në Komunën e Gjakovës në bazë të Akt Emërimit me numër 01-112-143-41 të datës 12.03.2012 në pozitën "Kurir i Zyrës së vendit Rogovë" në Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër 01-112/02-8061 të datës 31.03.2022 lidhur me transferimin nga pozita "Kurir" në pozitën "Zyrtar për Telefoni"

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga analizimi i provat materiale lidhur më çështjen në procedurë vëren se me Vendimin Nr. 01-112/02-6281 të datës 15.03.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është vendosur për ristrukturimin e Sektorit të Gjendjes Civile dhe Sektorit për Inspektive, me arsyetimin se në Sektorin e Gjendjes Civile janë katër (4) nëpunës me pozitë të korrierit e të cilit nuk janë të nevojshme në këtë sektor, ndërsa sa i përket Sektorit për Inspektive në vitin 2021 të gjithë inspektorët sanitarë në kuadër të Komunës së Gjakovës janë bartur në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës sipas transferimit të bërë në të gjitha komunitat. Si pasojë e këtij ristrukturimi Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore me Vendimin Nr. 01-112/02-6886 të datës 21.03.2022, ka themeluar Komisionin e ristrukturimit në përbërje nga tre anëtarë, i cili me Propozimin Nr.01-112/02-7590 të datës 28.03.2022 ka propozuar transferimin e ankuesit nga pozita Kurir në pozitën Zyrtar për Telefoni në kudër Sektorin për Siguri dhe Emergjencë, e komform këtij propozimi Menaxheri i Burimeve Njerëzore me Vendimin me Nr. 01-112/02-8061 të datës 31.03.2022, ka transferuar anketuesin nga pozita Kurir në pozitën Zyrtar për Telefoni në kudër në Sektorin për Siguri dhe Emergjencë, Drejtoria për Mbrotjtje dhe Shpëtim.



Kolegji bazuar në listën e verifikimit të statusit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pozita e ankuesit *kurir* është kategorizuar si pozitë e nëpunës administrativ dhe mbështetës, kështu që nisur nga ky fakt dhe në kuptim të dispozitave të nenit 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilat është përcaktuar se: *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*, dhe meqenëse objekti i vet ankesës së ankuesit ka të bëjë me pretendimin që të kthehet në pozitën kurir e cila nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil, kështu që bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.334/2022 të datës 06.04.2022, të parashtruar nga ankuesi


Bazuar në rrethanat si me lartë, e në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi administrativ dhe mbështetës ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.334/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

